

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 207 Prot.

Tiranë, më 13.022017

VENDIM Nr. 27, datë 09.02.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2 të datës 09.02.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim projekti për "Godinë 5 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë", Lagjia Nr. 1, rruga "Nako Spiro" dhe rruga "De Rada", Durrës, zona arkeologjike "B", paraqitur nga subjekti "FAKLE" sh.p.k. si dhe kërkesën e paraqitur paraprakisht. për shqyrtim të një koncepti gërmimi arkeologjik të shpëtimit, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "A.KeR." sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Kërkesa e paraqitur paraprakisht për Konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "A.KeR." sh.p.k., duhet të kalojë më parë për shqyrtim e vendimarrje, në Këshillin Shkencor të Institutit të Arkeologjisë.
2. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të përcjellë Konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "A.KeR.", pranë Institutit të Arkeologjisë.
3. Pas miratimit të tij në Këshillin Shkencor të Institutit të Arkeologjisë, do të vijojë procedura e shqyrtimit të tij në KKA e radhës dhe më tej deri në vendimarrjen për projektin e sipërpërmendur.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO-FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO